

VENDIM
Nr. 16, datë 9.1.2025

**PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2025, NË INSTITUCIONET
E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL**

(Ndryshuar me VKM nr. 468, datë 31.7.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2025 është gjithsej *1196*, të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

- | | |
|---|--------------|
| a) Për Trupën e Nëpunësve Civilë të Nivelit të Lartë Drejtues | <i>15</i> ; |
| b) Për kategorinë e mesme drejtuese | <i>93</i> ; |
| c) Për kategorinë e ulët drejtuese | <i>283</i> ; |
| ç) Për kategorinë ekzekutive | <i>805</i> . |

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike;
- Audit i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;
- Histori-filologji;
- Shkenca mjekësore;
- Veterinari;
- Agronomi;
- Zootekni;
- Mbrojtje bimësh;
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
- Kimi;
- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Shkenca inxhinierike;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Artet e bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca ekzakte;
- Shkenca edukimi;
- Mësuesi;
- Arsimit i lartë ushtarak/policor;
- Arsimit i lartë.

3. Institucionet e administratës shtetërore, ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2025, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Fondet buxhetore për vendet vakante të planifikuara për rekrutim për vitin 2025 janë pjesë e fondeve buxhetore, të miratuara me ligjin e buxhetit për vitin 2025 për secilin institucion të administratës shtetërore.

5. Plotësimi i vendeve vakante në kategorinë ekzekutive, gjithsej 805, në kategorinë e ulët drejtuese, gjithsej 283, apo kategorinë e mesme drejtuese, gjithsej 93, bëhet së pari nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ku mund të konkurrojnë nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira.

6. Vendet që mbeten të lira në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele:

a) për kategorinë ekzekutive plotësohen nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil, ku mund të konkurrojnë të gjithë ata kandidatë jashtë shërbimit civil që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, të përcaktuara në shpalljen e konkurrit;

b) për kategorinë e ulët dhe atë të mesme drejtuese plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, ku mund të konkurrojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira.

7. Plotësimi i vendeve vakante në Trupën e Nëpunësve Civilë të Nivelit të Lartë Drejtues bëhet sipas përcaktimeve në nenet 27–30, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

8. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Lidhja nr. 1

Lista e institucioneve të administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2025

1. Kryeministria dhe institucionet në varësi të saj;
2. Sistemi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
3. Sistemi i Ministrisë së Brendshme;
4. Sistemi i Ministrisë së Mbrojtjes;
5. Sistemi i Ministrisë së Financave;
6. Sistemi i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
7. Sistemi i Ministrisë së Drejtësisë;
8. Sistemi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
9. Sistemi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
10. Sistemi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
11. Sistemi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
12. Sistemi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.